



**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 2911/1 Prot.

Tiranë, më 02/12 2020

Lënda: Dërgim informacioni mbi gjyqtarët dhe prokurorët për të cilët është kërkuar procedim disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS ✓

Për dijeni:

AVOKATIT TË POPULLIT

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 4105 prot., datë 01.12.2020 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2911 prot., datë 01.12.2020 me anë të së cilës është kërkuar informacion mbi gjyqtarët dhe prokurorët për të cilët ka filluar procedim disiplinor, ju informojmë se deri tani Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor procedimin disiplinor për 2(dy) gjyqtarë dhe pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë procedimin disiplinor për 1(një) prokuror, konkretisht si më poshtë:

Shkresa regjistruar me nr. 664/4 prot., datë 22.09.2020 drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Shkëlqim Miri, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

Shkresa regjistruar me nr. 313/43 prot., datë 30.07.2020 drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Markelian Kuqo me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;

Shkresa regjistruar me nr. 251/31 prot., datë 21.07.2020 drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Elina Kombi me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI I LARTË TË DREJTËSISË

Artur Metani